

Adresa: Rruga "Gjin Bua Shpata", Pall.e Aviacionit të Vjetër, Shk.4, Ap. 16, Tiranë, Shqipëri
Mob: +355 67 604 52 40 E-mail: center@albania-export.com
Ëeb: <http://albania-export.com> FB: /ALB.Export Të: /alb_export

Nr __56__ Prot.

Tiranë, më: 07.08.2017

Lënda: Sygjerime propozime për draft Projekt – Ligj “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin Nr. 10433 datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë””

Drejtuar: **Z. Shkëlqim HAJDARI**
Inspektor i Përgjithshëm

Jemi njohur me draft ligjin “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin Nr. 10433 datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë””

Çështjet e problematikat e inspektimit kanë qenë tejet serioze dhe duhet ta themi se biznesi ka qenë tejet entuziast kur u ndërmor nisma dhe u miratua ligji aktual në fuqi për inspektimin, i cili sanksionon disa parime themelore dhe rregulla bazike - zbatimi i të cilave në tërësi në këto vite lë shumë për të dëshiruar.

Në këtë kontekst shprehim vlerësime për iniciativën për këto ndryshime ligjore, që kanë qëllim garantimin e profesionalizmit të trupave inspektuese, garantim të një procesi të rregullt ligjor dhe ndryshimin e perceptimit të inspektimit nga klientelist e korruptiv në ndihmë dhe këshillim për bizneset.

Gjithashtu shprehim vlerësimet maksimale edhe për nismën Tuaj për konsultim publik *të thellë e real, të adresuar edhe për aktorë të veçante*, në kuadër të ndryshimit të këtij ligji.

Kjo procedurë konsultimi e ndjekur nga ana Juaj është e dukshme që nuk ka si qëllim reklamën e propagandën, por ngritjen e një procesi real konsultimi, i besueshëm nga palët e interesuara për rrjedhojë është mirëpritur e ka nxitur e garantuar përfshirjen e tyre.

Pra e vlerësojmë që kjo nismë e Juaja është pasqyrim i drejtpërdrejtë i zbatimit të ligjit nr. 146/2014 ‘për njoftimin dhe konsultimin publik’ - ligj i mirëpritur nga publiku i gjerë, por mbi të gjitha nga biznesi.

Nga studimi modest që u përpoqëm ti bëjmë këtij drafti, por edhe nga përvoja që kemi në advokim ndaj subjekteve po përcjellim disa sygjerime e komente, të cilat mendojmë se janë të dobishme për të parandaluar shkeljet e imponuar rritjen e stadardeve dhe të zbatimit të ligjit nga subjektet, si dhe për të parandaluar përdorimin e inspektimit si ‘hanxhar’ e mjet presioni për dhënie mite apo më keq akoma për të parandaluar diskriminimin në funksion të veprimeve kriminale të një konkurrenti kundër konkurrentëve të tjerë etj..

I. Në ligjin aktual apo/dhe ndryshimet e tij, përcaktohen qartësisht parimet e inspektimit nga të cilat po veçoj

- ✓ Parimin e programimit të inspektimeve, programim i cili bazohet në vlerësimin e riskut
- ✓ Parimin e transparencës dhe informimit

por që në gjykimin tonë, sanksionimi i këtyre parimeve në ligj është vetëm deklarative e nuk ka asnjë masë që garanton zbatimin e tyre. Në funksion të garantimit të tyre, gjykojmë se duhet

1. të përcaktohet në ligj detyrimi i inspektorateve që të bëjnë vlerësimin e riskut për fushën e vet të veprimtarisë dhe më tej edhe ta publikojnë atë.

- ✓ Një masë e tillë (për hartimin, miratimin e publikimin e vlerësimit të riskut) do të impononte që inspektoratet të njohin mirë e shumë mirë problematikën e fushës përkatëse e për rrjedhojë do jenë të detyruara që ti orientojnë kapacitetet pikërisht në këto drejtime
- ✓ Publikimi i këtij dokumenti të rëndësishëm do i jepte mundësi çdo subjekti që të bëjë vetkontroll dhe ti marrë në avancë masat përmirësuese;
- ✓ Publikimi i këtij dokumenti të rëndësishëm, do i jepte mundësi grupimeve të bizneseve apo ekspertëve të ndryshëm që të bëjnë edhe opionencë (mbi bazë të të cilës ky dokument të përmirësohet në vijimësi, pasi natyrshëm që një dokument i tillë është dinamik e jo statik)

Pikërisht mungesa e analizës së riskut ka sjellë paradoksin që subjektet e palicensuara të mos kontrollohen fare , kur ato në fakt përbëjnë dhe riskun më të lartë

2. të përcaktohet në ligj detyrimi i inspektorateve që të publikojnë raport çdo 6 mujor (na duket pak të përcaktohet vjetor) për arritjet e punës së tyre, konkretisht

- ✓ numrin e kontrolleve të ndara sipas gjeografisë, ritmikës së tyre (që të demonstrohet se inspektimi është një proces i vazhdueshëm dhe jo me aksione) dhe kategoritë e subjekteve të inspektuara (lloj industrie apo shërbimi etj.) psh ka trupa inspektuese që 80% të inspektimeve e realizojnë tek "trau i doganës"
 - ✓ gjetjet kryesore dhe numri i masave administrative të marra si dhe vlera e tyre
 - ✓ numri i kallëzimeve penale ndaj subjekteve për rastet kur shkeljet e tejkalojnë klasifikimin si administrative (p.sh. ka shumë të tilla në fushën e ushqimit apo mbrojtjes së mjedisit por nuk ka asnjë kallëzim nga trupat inspektuese – ky konkluzion mbështetet nga verifikime që kemi kryer apo edhe të dhëna mediatike)
 - ✓ numrin e kërkesave ankimore ndaj dënimeve administrative, numrin e ankimeve të pranuar në proces administrativ
 - ✓ ecurinë statistikore të çështjeve në gjykatë dhe masat korrektuese të marra
3. të përcaktohet në ligj detyrimi që secili Inspektorat, duke ruajtur të dhënat konfidenciale të subjekteve, për qëllime të informimit, të publikojë në faqen e saj zyrtare të internetit ,
- opinionet që japin qëndrime për zbatimin e legjislacionit të fushës
 - vendimet e apelit administrativ
 - çdo tre muaj një buletin informativ mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet e fushës dhe në bazë të tyre reflekton vendimet teknike të cilat zbatohen për raste të tjera të ngjashme.

Publikimi i këtyre sa më sipër (sidomos vendimeve të apelit administrativ - natyrisht në përputhje me ligjin e ruajtjes të të dhënave personale) arrin shumë qëllime njëkohësisht;

- Së pari e bën më të përgjegjshëm apelin administrativ për mënyrën e trajtimit, arsyetimit dhe bazueshmërinë e besueshmërinë e vendimeve
- Ndhmon biznesin që të orientohet lidhur me interpretimin e ligjit dhe qëndrimin e organit më të lartë për zbatimin e legjislacionit
- Ndhmon edhe inspektoratet rajonale dhe mbarë strukturat/punonjësit për unifikim të qëndrimeve dhe praktikave të punës

Në gjykimin tonë, inspektimi përveç se mjet për të ndëshkuar shkelësit është e duhet të jetë si sondazh në terrenin konkret dhe në këtë kuptim gjetjet e problematikave duhet të vlerësohen prej institucionit/inspektoratit përveçse në aspektin e ndëshkimit të rastit konkret edhe në aspektin e bërjes së rekomandimeve ndaj institucionit të linjës për të marrë masa korrigjuese apo vendime e iniciativa ligjore për përmirësime të tilla që të impaktojnë në parandalimin e shkeljeve

- II. Në lidhje me nene e pika të veçanta ku mund të jepet ndonjë opinion për një ndryshim pike apo gërmë nuk jemi involvuar pasi së pari e gjemë të shkruar mirë e qartë draftin (sipas

grykimit tonë) por po veçojmë disa pikë konkrete për të parashtruar probleme që shtrihen për zgjidhje në kuadër të këtyre ndryshimeve ligjore (jo thjesht korrigjim).

1. Kështu Neni 20 Misioni dhe funksionet e Inspektoratit Qendror jepen të mirë përcaktuara e detajuara, për të cilat në pikën 5 të këtij neni specifikohet se
 - Procedurat e hollësishme për ushtrimin e kompetencave të Inspektoratit Qendror, sipas këtij neni, ... miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave (ose emërtesa me ligj).

Në grykimin tonë kjo nuk është e mjaftueshme! Nuk është çudi që ushtrimi efektiv i këtyre kompetenca të mbeten në dorë të vullnetit të ministrave të linjës dhe gjithë përpjekja e Inspektoratit Qendror të mbetet në kuadër të korrespondencës shkresore.

Për rrjedhojë grykojmë se inspektorati qendror duhet të ketë të parashikuar në ligj kompetencën për inspektim/auditim ndaj inspektoriateve (inspektim në vend apo distancë) dhe aplikimit të dënimeve administrative me gjobë, rekomandime për masa tjera administrative dhe kallëzime penale.

Në këtë mënyrë do të garantohet kompetenca e Inspektoratit Qendror për të ndikuar në çështje të fushës së kompetencës, por edhe do të ngarkohet me pjesën e vet të përgjegjësisë për problematikat.

Për analogji parashtrojmë psh se më herët e drejta e informimit të publikut për informacione e dokumente nga administrata ishte e rregulluar në ligjin për avokatin e popullit – i cili kishte edhe mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj të drejte. Mirëpo ligji nuk përcaktonte sanksion për shkelësit.!

Dihet se kjo e drejtë është nëpërkëmbur dhe se impakti i ligjit ishte thujse zero.

Tashmë dihet po ashtu se ligji për informimin ka një Komisioner që mbikëqyr këtë të drejtë dhe ka kompetencën e sanksioneve, për rrjedhojë edhe përgjegjësinë për ti ushtruar ato ndaj institucioneve e zyrtarëve të caktuar që e shkelin këtë të drejtë.

2. Sipas Neni 31 Autorizimi i një inspektimi Autorizimi nuk mund të ankimohet veçmas vendimit përfundimtar të inspektimit. Lëshimi i autorizimit në kundërshtim me parashikimet e neneve 28 - 31 të këtij ligji, nuk përbën, veçmas, shkak për pavlefshmërinë e vendimit përfundimtar të inspektimit, por përbën shkelje disiplinore për nëpunësin përgjegjës që ka lëshuar autorizimin.

Natyrshëm që parimisht nuk mund të përbëjnë shkeljet e procedurës së nxjerrjes së autorizimit shkak për pavlefshëri të vendimit, por gjithsesi mendojmë që duhet që të merret në konsideratë edhe rastet ekstreme kur shkeljet e procedurës së autorizimit (që kanë të bëjnë me inspektime në

bazë te programit sipas vlerësimit të riskut etj.) mund të kryhen në funksion të diskriminimit ndaj një subjekti - për efekt konkurrence të pandershme apo presion mite, apo në kuadër të krimeve elektorale.

Aq të përhapura janë sidomos këto të fundit, sa siç dihet vite më parë parlamenti ka miratuar një ligj për faljen e gjobave të vendosura në një periudhë të caktuar parazgjedhore për shkak se kishte dyshime e perceptim se krejt inicimi i procesit inspektues ishte në funksion të krimin elektoral (ndonëse i pavërtetuar apo/dhe ndëshkuar penalisht). Apo për analogji siç dihet edhe së fundi kishte vendime qeverie apo udhëzime për ndërprerje të përkohshme të inspektimeve pikërisht për shkak të kësaj droje (diskriminimin për arsye politiko elektorale).

Në këtë kuadër mendojmë që kur ka raste të tilla apo kur shkelja e procedurës së autorizimit të inspektimit është flagrante kjo mund të impaktojë edhe vendimin përfundimtar ose ose të sanksionohet në ligj jo veç: *‘përbën shkelje disiplinore për punonjës in përgjegjës’* por të përcaktohet edhe masa disiplinore që ndërmerret – largim nga shërbimi.

3. Sipas Neni 49 Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar 3. Nëse ligji i posaçëm parashikon që inspektori duhet të shqyrtojë dhe të marrë një vendim përfundimtar, të menjëhershëm, në përfundim të inspektimit, inspektori, përpara marrjes së vendimit, **i shpjegon subjektit të inspektimit shkeljet e konstatuara**, nëse ka të tilla, dhe vendimin që synon të marrë, **duke dëgjuar shpjegimet apo kontestimet e tij, të cilat pasqyrohen në procesverbal**. Vendimi përfundimtar pasqyrohet në procesverbal, i cili mbahet dhe njoftohet sipas pikave 1-3 të nenit 48 të këtij ligji. Shpjegimi dhe dëgjimi i subjektit nuk është i nevojshëm kur nuk konstatohen shkelje të kërkesave ligjore. Pika 5 e nenit 48 të këtij ligji nuk zbatohet në këtë rast.

Gjykojmë se është e domosdoshme të sanksionohet në ligj detyrimi i inspektoratit që, në vendimin e marrë apo së paku në vendimin e marrë në shqyrtim të ankimit të subjektit të dënuar, jo vetëm ti pasqyrojë pretendimet/kontestimet e subjektit të inspektuar por edhe të shpreh me shkrim dakortësinë apo kundërshtimet/pavlefshmërinë e argumenteve të subjektit përball gjetjeve dhe vendimit të marrë. Në rastin kur kundërshtohen argumentat e subjektit të inspektuar, ky kundërshtim duhet të jetë i arsyetuar dhe bazuar në norma specifike.

Në këtë mënyrë

- do të garantohej që subjekti gëzon jo vetëm të drejtën për të folur por edhe për tu dëgjuar.
- Aktet dhe inspektimi do të ishin më të arsyetuara dhe efektivisht do të garantohej një ‘shkallë gjykimi’ e vërtetë mes qëndrimeve të palëve
- Do të rritej pesha e inspektorëve dhe e inspektimit, pasi qëndrimi i subjektit të inspektuar do të imponohej të bëhej më i përgjegjshëm

- Do të garantohet shqyrtimi i fakteve dhe rrethanave për rrjedhojë do të ritej cilësia e inspektimit dhe vendimarrjes

Jeni të lutur që për rekomandimet tona që nuk pranohen, atëherë në zbatim të neni 11 dhe 19 të Kreu IV ‘Rregullat e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik’ të ligjit nr. 146/2014 ‘për njoftimin dhe konsultimin publik’, përmbledhjen e arsyeve të mospranimi të tyre na i njoftoni.

Alban Zusi

Drejtor Ekzekutiv